



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QENDRA KOMBËTARE E URGJENCËS MJEKËSORE
DREJTORIA E FINANCES INVESTIMEVE DHE BUXHETIT**

Nr. 123 Prot

Tiranë, më 19 . 02 2024

Lënda: Raporti i Monitorimit të Buxhetit për vitin 2023

**MINISTRISË SE SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Rruga e Kavajës, Tiranë**

Në mbështetje të Ligjit nr.84/2022, “ Për buxhetin e vitit 2023” AN nr.5, datë 18.10.2023, në vijim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018, “për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit,, i ndryshuar , “Udhëzimit plotësues nr.2, datë 19.01.2023” Për zbatimin e buxhetit 2023”, Udhëzimit nr.22, datë 17.11.2016 ”Për procedurat ztandarte të të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, lutemi gjeni bashkëlidhur raportin e Monitorimit të Buxhetit të vitit 2023 për QKUM-në.

Raporti i monitorimit i vitit 2023, krahas analizes së shpenzimeve buxhetore , përmban dhe një analizë të objektivave institucionale të performancës buxhetore të orientuara drejt rezultateve.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj!

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Skënder Brataj



RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE SIPAS ARTIKUJVE PËR VITIN 2023.,

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM) është institucioni përgjegjës për zhvillimin e sistemit të shërbimit të urgjencës mjekësore, nëpërmjet planifikimit, drejtimit, pjesëmarrjes dhe bashkërendimit të të gjitha aseteve ekzistuese në një sistem mbarështetëror të unifikuar, si dhe bashkërendimin e veprimtarisë me sistemet e ngjashme në vendet fqinje.

QKUM ka kryer monitorimin e buxhetit për vitin 2023, nëpërmjet vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore dhe krahasimit të treguesve faktik të performances me ato të planifikuara. Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohen niveli i realizimit të fondeve buxhetore të QKUM-së të detajuara në nivel kategori shpenzimi buxhetor kundrejt treguesve të planifikuar .

Në mbështetje të Ligjit nr.84/2022, “ Për buxhetin e vitit 2023,, AN nr.5, datë 18.10.2023 ,të vitit 2023, si dhe shkresat për ndryshimet e fondeve dhe në vijim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit,, i ndryshuar, Udhëzimit nr.2, datë 19.01.2023 “Udhëzimit plotësues për zbatimin e buxhetit 2023”, Udhëzimit nr.22, datë 17.11.2016 ”Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, për periudhën 2023, performanca e realizimit të buxhetit, paraqitet si më poshtë:

		në 000/ lekë					
Artikulli	Programi	Fakti 2022	Plan Fillestar V.2023	Plan në fund të V.2023	Fakti V 2023	Diferenca	Nw%
600	Paga	105980	99130	117130	115892	-1238	99%
601	Sigurime shoqerore e shendetesore	17536	15921	19421	19218	-203	99%
602	Shpenzime për mallra dhe sherbime të tjera	107943	451568	80556	74612	-5944	93%
606	Transferta te individet	1535	200	200	200	0	100%
Nën Tota	Shpenzimet Korrente	232994	566819	217307	209922	-7385	97%
231	Kapitale të trupëzuara		92000	12444	12444	0	100%
231	TVSH			5000	4885	-115	98%
231	TVSH IPA CBC			1804	1804	0	100%
231	Mobilje zyre			1200	0	-1200	0%
230	Kapitale të pa trupëzuara			2231	2231	0	100%
231	Kosto Lokale			18000	17614	-386	98%
Nën Tota	Shpenzime me Financim të Brendshem		92000	40679	38978	-1701	96%
	TOTAL	232994	658819	257986	248900	-9086	96%

ANALIZA E REALIZIMIT TE BUXHETIT TË QKUM-SË PËR VITIN 2023

1-Pagat dhe Sigurimet Shoqërore dhe Shendetësore . llogaria 600-601

Në zërin 600-601,

Në zërin Paga dhe Sigurime Shoqërore e Shendetësore ,për vitin 2023, në fillim të vitit janë celur 115,051 mije lek.

Me shkresën e MSHMS nr.1998/3, date 09.06.2023, ne zerin e pagave dhe sigurimeve shoq e shendetesore janë shtuar në buxhet dhe 21,500 mije leke, për efektin e Rritjes se pagave me Vendimin e KM Nr 245, datë 20.04.2023.

Për vitin 2023 buxheti i planifikuar në vleren 136,551 mije lek në zërin Paga dhe Sigurime Shoqërore e Shendetësore, është realizuar në vlerën 135,110 mijë lekë ose në masën 99%. Numri i punonjësve sipas strukturës në organikë i planifikuar gjatë Vitit 2023 ka qënë 86 (tetëdhjetë e gjashtë) , ndërkohë të punësuar në Vitin 2023 janë 77 punonjës të punësuar pranë QKUM-së

Nga punonjësit me kontratë të përkohshme janë planifikuar 49 (dyzetënëntë)

Përkatësisht 10 Mjekë, 20 Infermierë, 15 shoferë dhe 4 operatorë , të marrë këto me VKM nr. 56, datë 01.02.2023 “ Punonjësit me kontratë të Përkohshme në MSHMS dhe konkretisht të punësuar janë 40 (dyzet) punonjës.

Këta punonjës me Kontratë të përkohshme janë marrë duke patur parasysh fluksin në rritje të misioneve të urgjencës paraspitalore

2- Shpenzimet për Mallra e Shërbime të tjera, Llogaria 602

Në lidhje me (Art.602) Shpenzime Korrente listojmë më poshtë realizimin e shpenzimeve sipas natyrës, bazuar dhe në planifikimin e fondeve në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike.

- Peshën më të madhe të këtyre fondeve e zë “Blerje Set Uniforma” dhe “Blerje këpucë për personelin e shërbimit të urgjencës” në vlerën 14.499.000 lekë ,për paisjen e personelit të urgjencës mjekësore të Spitaleve Rajonale dhe Bashkiake, duke realizuar objektivin e vitit 2023.

- Buxheti u realizua dhe për zërat “Shërbimi Ruajtjes dhe sigurisë fizike në ambjentet e QKUM-së” në vlerën 17.726.485 leke me (kontratë 2022-2023 me Illyrian Guard sh.a) dhe kontrata 2023-2024 e cila është në vazhdim për Vitin 2024

- Gjithashtu u krye “Sigurimi i ndërtesës dhe asetëve të Q.K.U.M-së” në vlerën 5.740.000 -Një zë në realizimin e buxhetit të vitit 2023, zë shpenzime për blerje karburanti për autoambulancat e UM, të cilat u aktivizuan për të gjithë periudhën e Vitit 2023, në vlerën 4,291,649 lekë.

-Shpenzimet për “Shërbim GPS dhe monitorim për autoambulancat në Spitale dhe Urgjencën Mjekësore” në vlerën 9.787.680 lekë dhe shpenzime të tjera të realizuara si shpenzime për, riparim e mirëmbajtje, shërbime të ndryshme, shpenzime udhëtimi e dieta,energji, telefon, etj, blerje materiale kancelari, pastrimi, hidraulike, elektrike, etj

3- Transferta për buxhetet familjare, Llogaria 606

Në buxhetin e vitit 2023, në llogarinë 606, Fondi i vecante, janë celur në vlerën 200 mije lek, për shpenzimet për daljen në pension të punonjësve dhe ndihma në rast sëmundje dhe fatkeqësie në familje.

Shpenzimet e planifikuara në buxhetin e vitit 2023 janë realizuar në vlerën 200 mijë lekë Për raste sëmundje dhe raste fatkeqësie në familje.

4-Shpenzime për investime kapitale, Llogaria 230-231.

Bazuar në Buxhetin e vitit 2023, për zërin Investime me financim të brendshëm, me,, Shkresa MSHMS ,nr 18/5 date 26.01.2023, u akordua fondi prej 92,000 mije lekë për artikullin 231 në zërat :

- Blerje Autoambulanca në vlerën 87,000 mijë lek
- Projekt Preventiv për Ndërtimin e godinës së re të QKUM back up Vlorë.

Duke u mbështetur te Buxheti fillestar për QKUM , si dhe me ndryshimet e buxhetit përgjatë vitit 2023, me shkresën nr 3242/2 datë 10.10.2023, të MSHMS ,si dhe të AN nr.5,datë 18.10.2023, plani i buxhetit dhe realizimi sipas zerave , për artikullin 230-231 sipas kodeve të projektit, paraqitet si më poshtë :

Kodi i projektit	Përshkrimi	Plani Fillestar	Planii Rishikuar	Realizimi 2023	Në %
M133595	Blerje autoambulanca për sistemin shëndetësor	87,000	0	0	0%
22AC628	Projekt preventiv për ndërtimin e godinës së re të QKUM	5,000	2,231	2,231	100%
M133595	Blerje motore urgjence		12444	12444	100%
22AC632	TVSH për projektin e financuar nga Center of Excellence of BE		5000	4885	98%
22AC633	TVSH IPA CBC		1804	1804	100%
20AE207	Mobilje zyre		1200	0	0%
22AC637	Kosto lokale projekti Ipa II CBC		18000	17614	98%
	TOTAL	92,000	40679	38978	96%

-Për zërin blerje autoambulanca për sistemin shëndetësor, proceduara nuk u realizua nga Agjensia e Blerjeve të Përqëndruara,

- Në vitin 2023 është bërë projekti i ndërtimit të Godinës nr II të QKUM-së për shtimin e kapaciteteve dhe minimizimin e riskut të ndërprerjes së shërbimit për shkak të ndodhjeve të paparashikueshme të cilat bëhen shkak i rënies së NJ/K nr 1.

- **Në vitin 2023 u blene 4 motora**, të cilët janë të paisur me paisjet bazë për ndimën e parë duke u bazuar në Standartet e shërbimit të urgjencës, kombëtare dhe ndërkombëtare (direktiva CEN 1789:2007, i cili është standardi i Bashkimit Evropian për ambulancat dhe automjetet e transportit mjekësor. Ky standard evropian specifikon kërkesat për modelimin, testimin, performancën dhe pajisjen e ambulancave të përdorura për transportin dhe kujdesin e pacientëve. të cilat parashikojnë standartet bazë për autoambulancat si mjete të tjera të ndihmës së shpejtë dhe pajisjen e tyre.

Përdorimi i motorrave është edhe për terene të vështira të cilat shkurtojnë kohën për mbritje në terrene të vështira si dhe redukton kostot e shpenzimeve

-**Në zërin kosto lokale** ,mbështetur në ligjin nr. 37/2015 për “Ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit (IPA II, Marrëveshjen e Financimit nr.118, datë 02.03.2023 , të nënshkruar nga Qendra kombëtare e Urgjencës Mjekësore dhe **Spitali Politeknik Bari (si struktura leader i këtij projekti)**.

Për Projektin Interreg- IPA CBC Italy,-Albania-Montenegro 2014/2020, me titull: “*Promoting eHealth in cbc Area by Stimulating local Economies* “ u përdorën fondet buxhetore, deri në rikthimin e fondeve nga donatorët, e financimit të huaj.

-Në këtë zë u bë e mundur pagesa e shpenzimeve të kryera për blerjet e paisjeve për infarct.net për QKUM, në kuadër të projektit “*Promoting eHealth in cbc Area by Stimulating local Economies*”. Në vlerën 6,219 mije lek

-Në artikullin 231- TVSH IPA CBC, u pagua TVSH -ja për paisjet infarct.net, në vlerën 1,803 mijë lekë.

-**Gjithashtu u krye shpenzimi për pagesën e TVSH-së** për Pajisjet Mjekësore CBRN të dhuruara, në zbatimin e “Projekti 88 - Forcimi i Gatishmërisë Mjekësore dhe Aftësive të Përgjigjes së CBRN në vendet e Evropës Juglindore dhe Lindore”. **Dhuruasi Qendra e Shkencës dhe Teknologjisë në Ukrainë** ,në emër të Bashkimit Evropian, i përfaqësuar nga Komisioni Evropian (Autoriteti Kontraktor), i përfaqësuar nga Curtis Bjelajac, Drejtor Ekzekutiv i STCU.

-**Zëri paisje zyre** nuk u realizua për arsye të anulimit të procedurës së prokurimit.

ANALIZA E OBJEKTIVAVE INSTITUCIONALE TE QKUM-së, REFERUAR BUXHETIT TË ORIENTUAR NË REZULTATE

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM) është institucioni përgjegjës për zhvillimin e sistemit të shërbimit të urgjencës mjekësore, nëpërmjet planifikimit, drejtimit, pjesëmarrjes dhe bashkërendimit të të gjitha aseteve ekzistuese në një sistem mbarëshpërndarës të unifikuar, si dhe bashkërendimin e veprimtarisë me sistemet e ngjashme në vendet fqinje

1. QKUM koordinon dhe kontrollon cilësinë e shërbimit në kujdesin parësor, paraspitalor të spitaleve, bën vlerësimin, trajtimin dhe transportin me mjete që ka në dispozicion si

- mjete rrugore, malore, detare, ajrore për në urgjencën spitalore (autoambulancë, automedika, motor ambulancë, helikopter, mjete transporti detare e tjer)
2. Koordinon, asiston dhe monitoron ndihmën e parë për cdo person në kushtet e urgjencës mjekësore, duke filluar nga vendi i ngjarjes.
 3. Siguron kujdesin mjekësor të specializuar për cdo person në kushtet e urgjencës mjekësore.
 4. Siguron ndihmën e parë dhe kujdesin mjekësor të specializuar në raste të emergjencave shëndetësore dhe civile, nëpërmjet sistemit të koordinimit, pranë Njesisë së Koordinimit të Urgjencave Mjekësore në QKUM.
 5. Siguron transportin tokësor, malor, ajror dhe ujor të përshtatshëm për shpëtimin e jetës, ofrimin e kujdesit shëndetësor në kushtet e urgjencës mjekësore dhe transferimin në strukturat e specializuara.

Në sistemin e integruar EMMA dhe EMMA Statistics synohet të kryhet testimi i performancës së spitaleve rajonale dhe plotësimi i standardeve për Urgjencën Paraspitalore.

Duke marrë shkas dhe nga ankesa të qytetarëve për mungesë dokumentacioni dhe vonesa në mbërritjen e autoambulancës, është synuar të monitorohet plotësimi për pjesën e kartelës territoriale, orareve të misionit, dhe përdorimit të paisjeve dhe seteve të UM paraspitalore, komunikimit Spital - QSH.

Gjithashtu janë shënuar zonat POI në rajone për sistemin EMMA 6.1.2 për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve.

Në secilin rajon u realizua:

Analizë e misioneve dhe vonesave të tyre

Testimi i thirrjeve drejt 1-2-7

Testimi i komunikimit Q.SH dhe Spital Rajonale, Bashkiake për dokumentacionin e Urgjencës paraspitalore dhe nevojave të pajisjeve mjekësore në Q.SH:

- Monitor-Defibrilatorët e dhënë nga QKUM për shërbimin paraspitalor, janë përdorur, paisjet funksionojnë, ka pak raporte të shock-eve të kryera, ndodhen në autoambulancë. Pra këto paisje janë efektive, por nuk mjafton numri i tyre për tu pajisur të gjitha autoambulancat e papajisura me pajisje mjekësore.
- Setet e urgjencës mjekësore të dhëna nga QKUM, për shërbimin paraspitalor (set traume dhe diagnostifikimi) rezultojnë në autoambulancë për cdo turn. Funksionojnë plotësisht, përdoren me efektivitet, por nuk mjaftojnë për tu pajisur të gjitha autoambulancat e papajisura me materiale mjekësore
- Në vitin 2016 në bazë të Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë në strukturat spitalore është shtuar personeli për urgjencën paraspitalore, por rezulton se përveç QSUT, SUT, SQSHN, Spitalit Rajonal Shkoder dhe Spitalit Rajonal Vlorë, të gjitha Spitalet e tjera nuk kanë personel dhe postacione të dedikuara për shërbimin e urgjencës paraspitalore sipas Urdhrit të Ministrit.
- Spitalet Universitare (QSUT, SUT, SUSHN) duhet të kenë aktiv 15 ekipe të dedikuara për paraspitalorin, të ndara në postacionet përkatëse

Efektivisht ka vetem 9 ekipe për Tiranën, pra 6 më pak, por dhe këto nuk funksionojne të ndara në postacionet përkatëse.

Po kështu spitalet i menaxhojnë autoambulancat duke parë prioritetet e tyre sipas nevojave që ju paraqiten. Shpesh herë autoambulancat dalin nga shërbimi për shkak të mirëmbajtjes e cila, kërkon kohë, për pasojë ndikon në cilësinë, shpejtësinë e shërbimit të urgjencës paraspitalore.

Nga këto Spitale nuk i jepet prioriteti dhe vëmendja e duhur për të vënë në efikasitet autoambulancat për shërbimin e urgjencës mjekësore paraspitalore. Ky fenomen sjell për pasojë vonesa në kryerjen e shërbimit të urgjencës mjekësore në disa raste dhe refuzimin e shërbimit për mungesë të mjeteve si dhe menaxhimin vështirë nga Njësia e Koordinimit të QKUM-së.

Kjo mungesë ekpesh për Spitalet Universitare Tiranë, ka bërë që të aktivizohen maksimumet e QKUM-së për periudhën e pandemisë, me qëllim realizimin e transferimeve në spitale, eventet në zbatim të Ligjit 147/2014, datë 30.10.2014 “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”, neni 8, shkronja ç) dhe gj):

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM) ka këto përgjegjësi kryesore:
ç) siguron, sipas nevojave, transferimin e pacientëve në institucione që ofrojnë ndjekje shëndetësore dhe rehabilitim, kur është e nevojshme të arrihet rikuperimi maksimal për pacientët;

gj) siguron që shërbimi i urgjencave mjekësore, gjatë katastrofave dhe situatave të dëmtimeve në masë, është i aftë të ofrojë shërbim në një zonë të caktuar;

Për këto arsye u bë i domosdoshëm aktivizimi i ekipeve me personel të shtuar, mjekë, infermier dhe shoferë për mbulimin e shërbimit të urgjencës.

- Për Spitalet Rajonale dhe Bashkiake ka ambulanca për paraspitalorin, nuk behet ndarje e postacioneve të Urgjencës Mjekësore paraspitalore. Drejtoritë e Spitaleve u japin përparësi shërbimit brenda spitalit dhe nuk e kalojnë personelin e dedikuar për paraspitalorin në shërbimin e urgjencës paraspitalore. Duke qenë në këto kushte nuk kryhet as ndarja e postacioneve të Urgjencës Mjekësore,

Disa nga Spitalet referojnë se nuk ka personel të mjaftueshëm mjekësh për urgjencën paraspitalore. Për pasojë rritet rrishti i shërbimit të urgjencës mjekësore paraspitalore.

Autoambulancat ekzistuese janë akoma duke u plotësuar me paisje mjekësore, sete të urgjencës mjekësore për të përmbushur detyrat sipas standartit të vendosur, por vihet re se disa nga autoambulancat janë tejet të amortizuara, dhe në të shumtën e rasteve referohet mungesë e mirëmbajtjes së tyre, për pasojë këto mjete dalin nga shërbimi, duke krijuar kështu vështirësi menaxhimi nga Njësia e Koordinimit.

Autoambulancat e reja të shpërndara në spitale, përdoren nga spitali duke iu referuar prioritetëve të spitalit, pra jo për nevojat e urgjencës paraspitalore

Në këto kushte paisja e autoambulancave ekzistuese me paisje mjekësore, sete të urgjencës mjekësore sipas standartit është në proces të vazhdueshëm në mënyrë që të menaxhohet në mënyrë optimale shërbimi i urgjencës mjekësore paraspitalore.

- Sistemi i monitorimit me GPS-se është autorizuar pranë QKUM-së nga Ministria e Shëndetësisë. Janë të regjistruara të gjitha autoambulancat të cilat raportojnë edhe monitorohen nga QKUM.
- Për zbatimin e detyrave që lindin për Regjistrin të Urgjencës Mjekësore në zbatim të Urdhrit nr.35, datë 10.05.2018 është realizuar:
 - Komunikim i vazhdueshëm me Spitalet Rajonale me qëllim mbledhjen e raportimeve ditore/javore/mujore dhe pasqyrimi i tyre në database
 - Raportim në periudha periodike i të dhënave të mbledhura
 - Komunikimi me koordinatorët e spitaleve dhe mbledhja e kartelave territoriale të plotësuar nga mjekët dhe infermierët.
 - Arkivimi i kartelave territoriale pas kontrollit duke respektuar rendin kronologjik.

Në përfundim të kontrolleve janë mbajtur relacione analitike mbi ecurinë e shërbimit të Urgjencës Mjekësore paraspitalore në cdo Spital Universitar, Rajonal, Bashkiak dhe Qendrat Shëndetësore 24 orëshe dhe janë bërë rekomandimet përkatëse.

-Në Vitin 2023 është rritur numri i thirrjeve , duke arritur në 412014 thirrje për ndihmë mjekësore duke kapercyer parashikimin në masën 118%.
 Është ulur koha mesatare e mbërritjes së autoambulancave në masën 17.28 min nga 18 min të planifikuara
 Në Vitin 2023 është ulur numri i misioneve për ndihmë mjekësore nga parashiki në masën 3% duke kanalizuar një pjesë të thirrjeve drejt konsultës mjekësore dhe reduktimin e resurseve në territor si në autoambulance ashtu dhe në spital.

-Gjate vitit 2023, në QKUM, janë kryer një sërë trajnimesh dhe aktivitete me pjesëmarrje të gjerë të Mjeteve dhe Infermjereve nga Spitalet e Republikës së Shqipërisë, Qendrave Shëndetësore, Poliklinikave, Mjek Specialist, stafi urgjencave, Mjek familje, të studenteve të Universitetit të Sporteve si dhe janë zgjeruar tematikat e trajnimeve si më poshtë:

- Në vitin 2023 janë kryer 37 trajnime
- Kanë marr pjesë 1316 staf mjekësor, ku 510 mjek dhe 806 infermier nga të gjitha Spitalet e Republikës së Shqipërisë, Qendrave Shëndetësore, Poliklinikave, Mjek Specialist, stafi urgjencave, Mjek familje etj..
- Janë kryer 7 tema të ndryshme ku 5 janë të akredituara dhe 2 të paakredituar. Ndër temat përmendim; PHTLS, AMLS, BLS&D, Life Guard, Dhënia e ndihmës së parë, EKG,PTACLS,
- Për herë të parë është akredituar Trajimi dy ditore AMLS ku ka marrë pikët masimale si trajnim nga ASCKSH dhe janë zhvilluar 4 trajime vetëm në 2023 dhe është i vlefshëm për 3 vite në vazhdim.

- U përgatit riakreditimi i kursit me temë BLS Telefonik ku pritet vlerësimi i ekspertëve të jashtëm për miratimin e kursit I cili do të zhvillohet përgjat vitit 2024 – 2026

Disa nga Aktivitetet trajnimeve të kryera përgjatë vitit 2023 janë si më poshtë :

-Raportim dhe nxjerrja e të dhënave statistikore në lidhje me efektet anësore të vaksinës."

Ideimi, përpunimi I modeleve të reja të certifikatave për temat e trajnimeve që zhvillohen nga QKUM" Ideimi, përpunimi I fletëpalosjes me informacione mbi përdorimin e AED (Automatic External Defibrillation)/ Defibrilatori Automatik I Jashtëm"

Trajnim BLS&D Basic Life Support &Defibrillation me pjesëmarrjen e studentëve të Fakultetit të Mjekësisë", Trajnim NAEMT Instructor Course me pjesëmarrjen e instruktorëve të trajnimeve nga NAEMT."

Trajnim BLS&D Basic Life Support &Defibrillation me pjesëmarrjen e "

Kontrolli I Cilësisë & Edukimi në vazhdim:

Material mbi përmirësimin e cilësisë, sigurinë e pacientit dhe edukimin në vazhdim të personelit mjekësor"

Trajnim BLS&D Basic Life Support &Defibrillation me pjesëmarrjen e personelit mjekësor të Qendrave Shëndetësore."

Kursi Lifeguard- BLS&D Basic Life Support &Defibrillation me pjesëmarrjen e studentëve të Universitetit të Sporteve ,studentëve të Albanian University.

Publikimi / Dokumentimi I aktiviteteve/Promovimi I QKUM:

Trajnim me personelin e kopshteve/ çerdheve mbi BLS&D Basic Life Support &Defibrillation"

Trajnim PHTLS Pre-Hospital Trauma Life Support, me pjesëmarrje të personelit mjekësor të spitalve të Ballshit, Shkodres Lushnjës, Fier, Vlorë etj"

Workshop -Project Interreg IPA CBC në ambjentet e Hotel PLAZA"

Trajnim BLS&D Basic Life Support &Defibrillation me pjesëmarrjen e personelit mjekësor të spitaleve rajonale".

Trajnim PTACLS Interreg IPA CBC"

Parandalimi dhe edukimi I popullatës: Material sensibilizues në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit

Trajnim PTACLS në kuadër të projektit Interreg IPA CBC"

Trajnim EKG - Interpretimin e Elektrokardiogramës në kuadër të projektit Interreg-IPA-CBC me pjesëmarrjen e personelit mjekësor të urgjencës të spitaleve rajonale"

Konferenca II e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore

Trajnim AMLS -Advanced Medical Life Support në bashkëpunim me trajnerët italian të NAEMT"

Kursi Lifeguard- BLS&D Basic Life Support &Defibrillation në bashkëpunim me Universitetin e Sporteve si dhe pjesëmarrjen e studentëve të këtij universiteti"

Trajnim BLS&D Basic Life Support &Defibrillation me pjesëmarrjen e personelit mjekësor të NJVKSH (Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë)"

Parandalimi dhe edukimi I popullatës: Material sensibilizues në kuadër të Ditës Botërore të Ndihmës së Parë.

Trajnim BLS&D Basic Life Support &Defibrilation në bashkëpunim me Urdhërin e Infermierit dhe pjesëmarrjen e personelit infermieror të qendrave shëndetësore"

Trajnim ACLS dhe Sistemi Infarct.Net në kuadër të projektit Interreg-IPA-CBC."

TrajnimEKG - Interpretimin e Elektrokardiogramës në kuadër të projektit Interreg-IPA-CBC."

Workshop: Ç'rregullimet Neurologjike në kuadër të projektit Interreg-IPA-CBC."

Trajnim BLS&D Basic Life Support &Defibrilation dhe Sistemi Infarct.Net"

Trajnim ACLS dhe Sistemi Infarct.Net në kuadër të projektit Interreg-IPA-CBC."

Trajnim AMLS -Advanced Medical Life Support në bashkëpunim me NAEMT"

Janë përpunuar materialet dhe pershtatur si dhe është bërë Publikimi / Dokumentimi I aktiviteteve nëpërmjet , foto, video si dhe është bërë publikimi në rrjetet sociale.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Skënder Brataj



Punoi:E.Bregaj
Mirato:G.Vesho

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit		QENDRA KOMBETARE E URGJENCES MJEKESORE					Kodi i Grupit		7330	
Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit										
Programet		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)		
Titulli	Emertimi	Fakti i vitit paraardhes Vit i2022	PBA Vit i2023	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti2023	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	Buxheti Vjetor Plan i Periudhes/progressiv	Fakti i Periudhes/progressiv	Diferenca		
0001	7330	232,994.0	385,591.0	658,819.0	257,986.0	257,986.0	248,900.0	-9,086.0		
Totali i Shpenzimeve te Ministrise		232,994.0	385,591.0	658,819.0	257,986.0	257,986.0	248,900.0	-9,086.0		
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit										
Totali		232,994.0	385,591.0	658,819.0	257,986.0	257,986.0	248,900.0	-9,086.0		

Drejtori i Pergjithshem	Emri	
	Firma	
	Data	19.02.2024



[Handwritten signature]

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit Programi						Kodi i Grupit	
						Kodi i Programit	
Art.	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2022	(2) PBA Plan 2023	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	(5) Buxheti Vjetor Plan i Periudhës/progressiv	(6) Fakti i Periudhës/progressiv	(7)=(6)-(5) Diferenca	
600	Paga	97,791.0	99,130.0	117,130.0	117,130.0	115,892.0	-1,238.0	
601	Sigurime Shoqërore	16,331.0	15,921.0	19,421.0	19,421.0	19,218.0	-203.0	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	179,469.0	451,568.0	80,556.0	80,556.0	74,612.0	-5,944.0	
603	Subvencione						0.0	
604	Transferta Korente të Brendshme						0.0	
605	Transferta Korente të Huaja						0.0	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ		200.0	200.0	200.0	200.0	0.0	
Non-Total	Shpenzime Korrente	232,994.0	566,819.0	217,307.0	217,307.0	209,922.0	-7,385.0	
230	Kapitale të Patruëzuara			2,231.0	2,231.0	2,231.0	0.0	
231	Kapitale të Trupëzuara	92,000.0	92,000.0	38,448.0	38,448.0	36,747.0	-1,701.0	
232	Transferta Kapitale						0.0	
Non - Total	Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	0.0	92,000.0	40,679.0	40,679.0	38,978.0	-1,701.0	
230	Kapitale të Patruëzuara						0.0	
231	Kapitale të Trupëzuara						0.0	
232	Transferta Kapitale						0.0	
Non - Total	Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
Totali	Shpenzime Kapitale	0.0	92,000.0	40,679.0	40,679.0	38,978.0	-1,701.0	
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti								
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh,jashte limiti)		232,994.0	658,819.0	257,986.0	257,986.0	248,900.0	-9,086.0	

Drejtesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Emri
	Firma	Firma
	Data	Data

Emri: *Gledolololo*
 Firma: *[Signature]*
 Data: 19.02.2024



ANEKSI nr.3 "Raporti përmbljedhes i rezultimit te treguesve te performances/produktive te programit"

Emri i Grupit	Kodi i Grupit
Programi	Kodi i Programit
	7330

Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njësia matëse	Luhatjet ne Kostom per Njese												Komente
			I			II			III			IV			
A	B	C	D	Sasia e Faktive (sipas vitit realizuar)	Sipërzimet (sipas vitit realizuar)	Kosto per Njese (sipas vitit realizuar)	Sasia (sipas planit te vitit korent)	Sipërzimet (sipas planit te vitit korent)	Kosto per Njese (sipas planit te vitit korent)	Sasia e Faktive (ne fund te vitit korent)	Sipërzimet (ne fund te vitit korent)	Kosto per Njese Faktive (ne fund te vitit korent)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III
A	Reste te mbetur nga Njësia e Urgjencës Mjekësore	Numer misionesh		119,728	232,984	2	115,000	257,966	2	111,895	257,966	2	0	-1	0
B	Produkti					#DIV/0!			#DIV/0!			#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!
C	Treguesi i Performances					#DIV/0!			#DIV/0!			#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!
D	Produkti					#DIV/0!			#DIV/0!			#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!

Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njësia Matëse	Sasia e realizuar	Fakti i perditshaprogjektiv	Komente
A	Produkti			0.0	
D	Treguesi i Performances			0.0	

Treguesit e Performances/Produktit e realizuara nga perfortimi i te anshurave jashte limitit

Emri i Ekspertit Menaxhues te Programit	Emri	Drejtori	Emri
	Firma	Pergjithshem	Firma
	Data		Data

[Signature]
14.08.2017



ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te politikës se programit"

Periudha e Raportimit: viti 2023

Kodi i Programit	7330	Emeritimi i programit:	Komente												
Qellimi 1	Sherbimi Urgjences Mjekesore Paraspatialore														
Objektivi 1.1	Përmirësimi i cilesise sherbimit te urgjences mjekesore paraspatialore														
Objektivi 1.2															
Objektivi 1.3															
		Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	91304AP	Emeritimi i Treguesit te Performances **/Produktit	Numri i thirrjeve per urgjencia mjekesore i adresuar ne Njesite e UM	Niveli faktik i vitit paraardhes	501911	Niveli i planifikuar ne vitin koorent	350000	Niveli i rishikuar ne vitin koorent	350000	Niveli faktik ne fund te vitit koorent	412014	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	118%	Ne Vitin 2023 eshte rritur numri i thirrjeve per ndihme mjekesore duke kapercyur parashikimin ne masen 118%
				Koha mesatare e reagimit (minuta)	18.1	18	18	18	18	18	17.28	104%	Ne Vitin 2023 eshte ulur koha mesatare e mberritjes se autoambulancave ne masen 17.28 min nga 18 min te planifikuara		
				Numri i misioneve te urgjences paraspatialore	119728	115000	115000	115000	115000	115000	111885	97%	Ne Vitin 2023 eshte ulur numri i misioneve per ndihme mjekesore nga parashikimi ne masen 3% duke kanalizuar rjete te thirrjeve drejte konsultes mjekesore dhe reduktimin e resurseve ne territor si ne autoambulancave ashtu dhe ne spital		
													#DIV/0!		
													#DIV/0!		
													#DIV/0!		

* Objektivat e listuar jane ne funksion te permbushjes se qellimit te mesiperm te politikës. Nese specifikohet me shume se 1 Qellim, ai se bashku me objektivat e tij (psh Qellimi 2 me Objektiv 2.1, 2.2, etj) duhet te futen ne nje table te njeshme, ne vazhdim te kesaj.
 ** Si tregues per vlerësimin e performances se objektivave, krahas produkteve, shërbejnë edhe tregues të tjerë të matshëm të lidhur me to. Këtu mund të jene standarde të njohura të fushës; tregues statistikorë; indeksë kombëtare e ndërkombëtare, etj.
 *** Këtu listohen te gjithë treguesit e performances, perfish dhe produktet behet periodik dhe vjetor, ndersa raportimi per treguesit e performances mund te behet edhe vetem vjetor, nqs matshmeria e tyre periodike paraqet veshtiresi objektive.
 Njehkonesisht, per ato tregues performace te cilet nuk vleresohen mbi baze vjetore por disa vjetore (psh vleresime ndërkombetore te tilla si: OBI, PISA score, PEFA score, etj), si niveli i vitit paraardhes vendoset niveli me i fundit i regjistruar per ta.

Drejtesi i Ekspit Menaahues i8 Programit	Emri	Shkurtin Blatej	Emri	
	Firma	<i>[Signature]</i>	Firma	
	Data	19.07.2024	Data	19.02.2025



ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"

Projektet me financim te brendshem (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti Kontraktuar	Plan i buxhetit vitit 2023	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI për periudhën e raportimit (12-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit projektit deri në periudhën aktuale	Komente
M133595	Blerje autoambulanca për sistemin shëndetësor					12444	12444	12444		
M133595	Blerje motore urgjence					2231	2231	2231		
22AC628	Projekt preventiv për nderimin e godines se re teback up te QKUM				5000	5000	4885	4885		
22AC632	TVSH per projektin e financuar nga Center of Excellence of BE				1804	1804	1804	1804		
22AC633	TVSH IPA CBC				1200	1200	0	0		
20AE207	Mobilje zyre				18000	18000	17614	17614		
22AC637	Kosto lokale, projektit jpa II CBC									

Projektet me financim te huaj (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Grant/ Kredi	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti Kontraktuar	Plan i buxhetit vitit	REALIZIMI për periudhën e raportimit (4-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit projektit deri në periudhën aktuale	Komente

Drejtori i Ekspit Menaxhues të Programit	Emri	
	Firma	
	Emri	
	Firma	
	Data	14.02.2024

